

VENDIM
Nr. 299, datë 18.11.2022

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 41, DATË 10.3.2022, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘AGE KUÇ’ SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC ‘KUÇ’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1930 kw”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullatorët të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.11.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1948/3 prot., datë 16.11.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s n. 41, datë 10.3.2022, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Age Kuç’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Kuç’ me kapacitet të instaluar 1930 kw””,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 41, datë 10.3.2022, ka vendosur:

1. Të licencojë shoqërinë “AGE Kuç” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kuç”, me kapacitet të instaluar 1930 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria “Age Kuç” sh.p.k. të depozitojë lejen e shfrytëzimit të burimit ujor me afate të rinovuara, brenda datës 3.10.2022.

3. Shoqëria “Age Kuç” sh.p.k. të depozitojë në ERE VNM-në paraprake të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, brenda datës 19.4.2022.

4. ERE ka të drejtë të rishikojë këtë vendim në çdo kohë, në përputhje me plotësimin/mosplotësimin e kushteve të cituara më sipër e, po ashtu, në rast mosplotësimi të kushteve të licencës.

- ERE njoftoi shoqërinë për këtë vendimmarrje me shkresën nr. 49/8 prot., datë 18.3.2022, dhe më tej në respektim të plotësimit të afatit të këtyre kushteve, ERE, me shkresën nr. 49/9 prot., datë 12.4.2022, i ka sjellë në vëmendje shoqërisë të depozitojë VNM-në paraprake të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM).

- Me depozitimin në ERE të VNM-së paraprake të lëshuar nga AKM-ja, rezulton se është plotësuar kushti i vendosur në pikën 3 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 41/2022, dhe si i tillë ky kusht duhet të shfuqizohet.

- Në kushtet kur shoqëria nuk ka filluar ende operimin, vlerësohet që në kuadër të mbikëqyrjes, t’i kërkohet të depozitojë në ERE informacion mbi fillimin e punimeve për ndërtimin e veprës jo më vonë se 2 (dy) muaj para përfundimit të vlefshmërisë së VNM-së, pra brenda datës 6.4.2024.

- Në komunikimet e mbajtura me shoqërinë “Age Kuç” sh.p.k., si dhe në vijim me Agjencinë e Mbrotjes së Burimeve Ujore (AMBU), rezulton se shoqëria ka aplikuar për rinovimin e lejes së përdorimit të burimit ujor për HEC “Kuç” dhe është në fazë trajtimi. Ndodhur në të tilla rrethana, vlerësojmë që pika 2 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 41/2022 të ndryshojë dhe të bëhet:

“2. Shoqëria “Age Kuç” sh.p.k. të depozitojë në ERE lejen e shfrytëzimit të burimit ujor të rinovuar, brenda 90 ditëve nga data e aplikimit në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, për rinovim.”.

- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2 e dispozitivit të vendimit nr. 41/2022 ndryshon dhe bëhet:

“Shoqëria “Age Kuç” sh.p.k. të depozitojë në ERE lejen e shfrytëzimit të burimit ujor të rinovuar, brenda 90 ditëve nga data e aplikimit në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, për rinovim.”.

2. Të shfuqizojë pikën 3 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 41, datë 10.3.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “Age Kuç” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kuç”, me kapacitet të instaluar 1930 kw.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti